



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Organi Shqyrtues i Prokurimit
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body

Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 0258/23

Data: 12.07.2023

Organi Shqyrtues i Prokurimit - Paneli Shqyrtues në përbërje të Kimete Gashi - Kryesuese, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "AEK Group" Sh.P.K. të datës 04.05.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 18.04.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest" me numër të prokurimit 616-23-14667-2-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas seancës së hapur të shqyrtimit të datës 21.06.2023 në prezencën e palëve, me datë 12.07.2023 merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** ankesa e operatorit ekonomik "AEK Group" Sh.P.K. me nr. 0258/23 e datës 04.05.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 18.04.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest" me numër të prokurimit 616-23-14667-2-1-1.
- II. VËRTETOHET** Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 18.04.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
- III. Lejohet ,OE ankues AEK Group" Sh.P.K ,** kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 29.12.2022 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest” me numër të prokurimit 616-23-14667-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 600,000.00 €. Kriteri për dhënie ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Me datë 18.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpallur fitues grupin e operatorëve ekonomik “Ar-Tech Bionvest Institute - Institut MOL”.

Me datë 19.04.2023 operatori ekonomik ankues "AEK" Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 26.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Duke qenë i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 26.04.2023, operatori ekonomik ankues me datë 04.05.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 258/23.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - *“Te kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesionale sa i përket stafit, AK, ka kërkuar gjithsej 6 punëtor të certifikuar për punë me Asbest sipas standardit ISO 29993, ndërsa si dëshmi është kërkuar CV, certifikatat e trajnimeve për asbest sipas te njëjtit standard. Grupi i OE-ve ankues, përmes ofertës ka prezantuar stafin e certifikuar sipas standardit ISO 29993:2017, të lëshuara me datën 22.01.2023, të vlefshme deri me datën. 22.01.2026, nga “AQScert”, rrjedhimisht arsyetimi i eliminimit të certifikata NIOSH 9002 dhe Iso 29993, është marrë pas datës së dorëzimit të ofertave është i pa qëndrueshëm dhe pa baze ligjore. Ndaj grupit tone, AK – Komuna Prishtine, përmes letrës standarde, ka kërkuar sqarim shtesë për dokumente të cilat janë pjesë e ofertës dhe asnjëri nga dokumentet nuk është nxjerre pas datës së hapjes së ofertave (13.03.2023), rrjedhimisht*

te gjitha dokumentet dheshkresat kane datën e fiksuar para skadimit te afatit për dorëzim te tenderëve, prandaj data e përshkruar 04.04.2023, ne shkresën sqaruese, te anëtarit te grupit tone dhe letrës sqaruese te datës 14.04.2023, nuk është dokument i plotësuar apo i nxjerre pas datës se hapjes se ofertave”.

Pretendimi i dytë (II) - “Për piken e dyte te eliminimit ne si grup i OE-ve, ne emër te anëtarit te grupit “Plinius SA”, ne oferte, kemi prezantuar, certifikatën me nr. 338-5, sipas standardit ISO 17025, e vlefshme deri me datën 17.04.2023, i akredituar si laborator, nga Hellenic Accreditation System, me përshkrim detal, për testime te materialeve, ku ne piken 2, përcaktohet materiali i testuar: Asbestos containing materials me standardin e aplikuar, “HSG248 Asbestos: The analysts guide for sampling, analysis and clearance procedures, Health & Safety Executive, UK, 2010. Edhe përmes sqarimit te ofruar nga AK, përgjatë fazës se ofertimit, përkatësisht me datën 15.02.2023 dhe 22.02.2023, vet AK, ka potencuar se: “...Operatori duhet te posedoj laborator te akredituar, sipas standardeve ISO 17025, duhet te ketë te akredituar metodën për analize te asbestit (polarization microscopy) NIOSH 9002. Rrjedhimisht ndryshimi dhe plotësimi i kërkesave kualifikuese nuk mund te behet përmes, pyetje /përgjigjeve, por përmes formave standarde te miratuara nga KRPP, formularit për korrigjim te gabimit. Pra standardi HSG248, është standard pasardhës dhe ekuivalent, madje standard me i avancuar se ai i përshkruar nga AK (NIOSH 9002), rrjedhimisht AK – Komuna Prishtine, ka kërkuar laborator te akredituar dhe kopjen e licencës se laboratorit sipas standardit 17025, ndërsa NIOSH, 9002 është metode e analizës se asbestit e viteve paraprake”.

Pretendimi i tretë (III) - “Grupi i OE-ve, ankues, përmes kërkesës për ri shqyrtim ka ngritur edhe pretendime ankimore kundrejt ofertës se OE, te rekomanduar për dhënie te kontratës, ku AK-Komuna Prishtinë, sipas vendimit te sajë te datës 26.04.2023, konsumon shkelje tjetër ligjore atë te paragrafit 8 dhe 9, te nenit 108/A, te LPP-se, pasi qe pretendimet tona fare nuk i trajton”.

Pretendimi i katërt (IV) - “Sipas qasjes ne ofertën e OE te rekomanduar për dhënie te kontratës, rezulton qe eksperti i prezantuar nuk e plotëson kërkesën kualifikues, pasi qe përveç kualifikimeve cv dhediplome, nuk është prezantuar kurrë far licence për trajtim te materialeve me përmbajtje asbesti, sipas normave te EU apo ekuivalence me normat e EU-se, me referenca ne asbest, lesh mineral apo substanca te rrezikshme, kërkesë kjo kualifikuese e përcaktuar ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate, rrjedhimisht AK – Komuna Prishtine do te duhej qe ofertën e OE te rekomanduar për dhënie te kontratës ta kualifikoj si oferte te pa përgjegjshme”.

Pretendimi i pestë (V) - “Grupi i OE-ve ankues është dashur te konsiderohej si i pa përgjegjshëm edhe për faktin se ne oferte nuk kane prezantuar marrëveshje për krijim te grupit ashtu siç obligojnë dispozitat ligjore sipas nenit 71, te LPP-se, përkatësisht nenit 26.1, te rregullores për prokurim publik nr. 001/2022”.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 28, 51, 59, 60, 69, 70, 71, 72 dhe 108/A të LPP si dhe nenin 26 të RRPP dhe nenin 10 të UPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim ndërsa oferta e parashtruesit të kualifikohet si e përgjegjshme.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 14.05.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si vijon: *“Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, eksperti i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OEankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim”*.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Ndërsa Operatori ekonomik ka dorëzuar te Paneli Shqyrtues njoftimin sipas të cilit pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Ndërsa Autoriteti Kontraktues ka dorëzuar te Paneli Shqyrtues njoftimin sipas të cilit nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit me arsyetimin si në vijim: *“AK, Komuna e Prishtinë , me dt 14.05.2023 ka pranuar Ekspertizen me nr 2023/0258 e cila ne vete përmban Mendim jo profesional nga ana e Ekspertit shqyrtues. Së Pari: grupi i Operatori ekonomik “AEK-Group” SH.P.K, në kërkesen për Ri-shqyrtim e ka dorëzuar me date 22.04.2023 në AK pretendimet ankimore kanë qenë te ndara në nën pika a) lidhje me piken 2.5, a) lidhje me pikën 3 pra vetëm dy pretendime te elaboruara gjate, kurse baza ligjore e pretenduar se eshte shkeluar ka qenë 65-71 dhe 72 i LPP.*

Ndërsa në ankesën e datës 04.05.2023 te derguar në OSHP, OE ankesen e ka te ndare në 5 pretendime pra shton pretendime te reja te cilat nuk i ka pasur fare ne Kërkesen për Rishqyrtim të dates 22.04.2023 si dhe bazen ligjore që pretendon se është shkelur e ndryshon 100% si me poshtë:
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Neni 28 - Specifikimet teknike, Neni 51 - Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, Neni 60 - Kriteret për Dhënie të Kontratës, Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, Neni 70 - Standardet për Sigurimin e Cilësisë Neni 71 - Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjes. Neni 10, - Udhëzuesit nr. 001/2023, për prokurim Publik (KRPP) Neni 26, - Rregullores nr. 001/2022, për prokurim publik (KRPP).

Ky veprim i OE-Ankues është në kundërshtim te plotë me Rregulloren për prokurim publik nr. 001/2022 saktësisht Nenin 64 Paraqitja e ankeses dhe afatet kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP saktësisht paragrafi 64.2 kërkon që kërkesa për ri-shqyrtim dhe ankesa në OSHP duhet të kenë pretendime të njëjta. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues se baza ligjore dhe pretendimet ankimore nuk janë të njëjta e dëshmon kërkesa për Ri-shqyrtim e datës 22.04.2023 dhe ankesa e bere me dt 04.05.2023. Ky veprim i OE ankues vetëm sa forcon arsyet e eliminimit te bere nga AK, per faktin se duke nderruar pretendimet

mundohet te arsyetoj veprimet e bere dhe dokumentet e dorëzuar ne kundërshtim me nenin 72 paragrafi 3 i LPP-së që kërkon ato te jenë para datës së hapjes dhe te verteohen ne menyre objektive. Andaj ky veprim i OE është dashur te trajtohet nga eksperti shqyrtues dhe ti ndihmoj atij te ketë një mendim profesional duke refuzuar ankesen e OE ankues sepse jane nderruar pretendimet dhe baza ligjore 100% nga ajo e dorezuar ne AK. Eksperti shqyrtues, duke e ditur se ANKESA e OE- ankues është dorëzuar në kunderështim me Rregulloren për Prokurim publik nr. 001/2022, Neni 64 Paraqitja e ankeses dhe afatet kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP saktësisht pargrafi 64.2 kërkon që kërkesa për ri-shqyrtim dhe ankesa në OSHP duhet të kenë pretendime të njejta; . Prap ka vazhduar me i trajtu pretendimet ankimore, dhe në fund nuk jep mendim që ankesa te aprovohet si e bazuar . Ne si AK mendojm se është obligim i ekspertit që të trajtoj çdo element të ankeses marrë parasysh se ne ekspertize askund nuk permendet ky element për ndryshim te pretendimeve ankimore kaq thelbesore, konsiderojm se eksperti nuk e ka trajtuar me profesionalizen ankesen në fjalë.

Për hirë të korretësisë po i elaborojmë faktet edhe njëherë nga ana e OE. Faktet janë si në vijim;

- 1. **AK- Komuna e Prishtinës**, me dt 13.03.2023, ka bërë hapjen e ofertave dhe ka pranuar gjithësej 5 oferta në mesin e tyre edhe ofertën e OE ankues.*
- 2. **AK- Komuna e Prishtinës**, me dt 12.04.2023, ka kërkuar sqarime shtese konform nenit 72 të LPP-së tek OE ankues dhe me dt 14.04.2023 kemi pranuar sqarimet nga OE të cilat mbajnë datën pas hapjes së ofertave pra 14.04.2023 dhe si të tilla janë në kundërshtim me nenin 73 paragrafi 3 i LPP-së. Përveç kësaj sqarimet e ofruara nuk kanë ofruar sqarime bindëse se me te vërtet OE e përmbush këkesen e dosje se tenderit.*
- 3. **AK- Komuna e Prishtinës**, ka aplikuar parimin e barazise dhe transparences, dhe po ashtu ka pasur parasysh edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, mbi këtë fakt ka aplikuar nenin 72 të LPP-së duke kerkuar sqarime shtese nga OE-të të cilët në ofertat e tyre kishin dorëzuar dokumentacion jo të plotë sipas kerkesave të dosjes se tenderit. Pas pranimit të përgjigjeve nga ana e OE duke i analizuar me kujdes të veçantë dëshmitë e ofruara shtesë komisioni profesional për vlerësim të ofertave ka konstatuar se OE ankues nuk i përmbush kerksat e dosjes se tenderit.*
- 4. **AK në njoftimin mbi vendimin e AK-së të publikuar me dt 18.04.2023** ka deklaruar te gjitha arsyet e eliminimit te OE dhe po ashtu ne vendimin per refuzimin e Kerkeses për Ri-shqyrtim i ka ri-perseritur te gjitha faktet ne te cilat është mbeshketur ne marrjen e vendimit per refuzimin e ofertës së OE ankues*
- 5. Ne si AK besojmë që nga faktet e prezantuara e te cilat eksperti i ka pasur në dispozicion ka mundur ti propozoj panelit mendimin per refuzimin e ankeses konform nenit 64 paragrafi 64.2 i rregullores për prokurim publik nr. 001/2022 për faktin se kemi të bëjmë me ndryshime të pretendimeve ankimore dhe atë tek baza ligjore e pretenduar si e shkeluar 100% ndersa tek pretendimet ankimore mbi 60% janë të reja e të cilat AK nuk i ka trajtuar fare.*

AK- Komuna e Prishtinës, respektivisht komisioni i vlerësimit ka vlerësuar ofertat bazuar në nenin 59 të LPP-së dhe në kriteret e parapara në njoftim për kontratë dhe dosje te tenderit. Andaj kërkojm

nga Paneli shqyrtues, pas elaborimit të të gjitha provave të marrë vendim duke e lënë në fuqi vendimin e AK-së për dhënie të kontrates dhe njëkohësisht të refuzohet ankesa pasi OE ankues ka ndryshuar pretendimet ankimore dhe nuk ka ofruar dëshmi se përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit”.

Me datë 21.06.2023 Paneli Shqyrtues ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues, përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues si dhe ekspertit shqyrtues. Gjatë seancës operatori ekonomik ankues ka qëndruar prapa pretendimeve ankimore si dhe ka konfirmuar se pajtohet me raportin e ekspertizës. Ndërsa autoriteti kontraktues ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e operatorit ekonomik ankues si dhe ka njoftuar se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës. Eksperti shqyrtues ka konfirmuar se qëndron pas raportit të dorëzuar të ekspertizës.

Në kuadër të fjalës përfundimtare Autoriteti Kontraktues thekson që “pretendimet në ankesën e operatorit ekonomik janë të ndryshme nga pretendimet ankimore në kërkesën për rishqyrtim të cilën e ka refuzuar Autoriteti Kontraktues. Ky fakt nënkupton që ankesa e operatorit ekonomik është në kundërshtim të plotë me nenin 64 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik ku përcaktohet që “Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në Autoritetin Kontraktues se baza ligjore dhe pretendimet ankimore nuk janë të njëjta e dëshmon kërkesa për Ri-shqyrtim e datës 22.04.2023 dhe ankesa e bere me dt 04.05.2023”. Këtë fakt si të tillë nuk e ka trajtuar fare eksperti shqyrtues në raportin e ekspertizës, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues nuk duhet t’i falë besimin raportit të ekspertizës lidhur me pretendimet ankimore të palejuara të operatorit ekonomik. Duhet shtuar se arsye për eliminimin e operatorit ekonomik ankues si tenderues të përgjegjshëm është se i njëjti ka dorëzuar një dokument shtesë pas datës së hapjes së ofertave në këtë aktivitet të prokurimit. Hapja e ofertave është bërë me datë 13.03.2023 ndërsa dokumenti shtesë është dorëzuar me datë 14.04.2023. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 72 të LPP kur marrim parasysh faktin se dokumenti për të cilin bëhet fjalë (NIOSH 9002 ISO certifikat 29993) është kërkesë e dosjes së tenderit. Prandaj në mungesë të këtij dokumenti komisioni vlerësues ka gjetur se operatori ekonomik ankues duhet të eliminohet si tenderues i përgjegjshëm pasi që nuk e plotëson këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Përndryshe Autoriteti Kontraktues edhe në vendimin me të cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim ka argumentuar mjaftueshëm se të gjeturat e komisionit vlerësues janë tërësisht të bazuara në LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Në anën tjetër as operatori ekonomik në ankesën e vet dhe as eksperti në raportin e ekspertizës nuk kanë arritur të parashtrojnë argumente, dëshmi apo prova me të cilat do të konstatohet se vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi kërkesën për rishqyrtim kishte për të mos qenë i drejtë dhe i ligjshëm, qoftë edhe një një fjalë të vetme të tij. Duke u nisur nga parimi “Da mihi factum dabo tibi ius” (më jep faktet, të jap të drejtën), nuk ekziston asnjë dilemë që as operatori ekonomik ankues dhe as eksperti shqyrtues nuk kanë arritur të përmbushin barrën e tyre të provës (“onus probandi”) ashtu që kishin për të vërtetuar pretendimet ankimore të cilat edhe ashtu si të tilla janë në palejuara në kuptim të nenit 64 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik”.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) dhe të dytë (II) ankimor eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës ka konstatuar se *“OE ankues pretendon që arsyetimi i eliminimit se certifikata NIOSH 9002 dhe ISO 29993, janë marrë pas datës së dorëzimit të ofertave është i pa qëndrueshëm dhe pa bazë ligjore. Teksti i plotë i pretendimeve ankimore të OE ankues është dhënë në sesionin 2 të këtij raporti, prandaj këtu do t’i referohemi atyre për aq sa është e nevojshme.*

Më 12.04.2023, AK ka kërkuar sqarime nga OE ankues, përmes Letrës standarde të kërkesës për informata sqaruese, në lidhje me:

- **Pikën 2.5.** Gjashtë (6) punëtor të certifikuar për punë me asbest sipas standarteve ISO 29993. **Dëshmitë e kërkuara:** CV, certifikata e trajnimeve për asbest sipas standarteve ISO 29993 - Kopjet e ISO 29993; si dhe

- **Pikën 3.** Operatori ekonomik duhet të posedoj laborator të akredituar sipas standarteve ISO 17025, dhe metodën të akredituar për analizë të asbestit (polarization microscopy) NIOSH 9002.

Dëshmitë e kërkuara: Kopje të licenses laboratorit të akredituar sipas standarteve ISO 17025.

Ndonëse i kishte dhënë afat dy ditor për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara, pra deri më 14.04.2023, Raporti i vlerësimit të tenderëve mban datën 13.04.2023! Në të thuhet që OE ankues *“nuk i plotëson kushtet lidhur me përshtatshmërinë administrative. Sqarimet e dhëna nga OE nuk janë bindëse për AK, për faktin që dokumentacioni i ofruar, Certifikata NIOSH 9002, ISO certifikata 29993 është marrë pas datës së dorëzimit të ofertave dhe konsiderohet plotësim dokumentacioni, ku është në kundërshtim me LPP-në”*. Rrjedhimisht, bazuar në Raportin e vlerësimit, më 18.04.2023, AK përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar njofton OE ankues se tenderi i tij është administrativisht i papërgjegjshëm për arsyen e cekur më lartë në këtë paragraf.

Në lidhje me këtë situatë, Neni 59 dhe 72 i LPP-së përcaktojnë si në vijim:

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave.
2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të

kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

3. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Autoriteti kontraktues menjëherë do t'i dërgojë të gjithë tenderueseve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

5. Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34, 35 të këtij ligji dhe paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, në lidhje me një tender të dorëzuar.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Më tutje, **Udhëzuesi Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik**, Sesioni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, jep shembuj konkret se si të veprohet në situata të caktuara.

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon licenca	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata	ISO Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Referuar dispozitave të mësipërme, pretendimet e OE ankues merren si të bazuara, pasi që dokumentet e kërkuara nga AK dhe të ofruara nga OE ankues brenda afatit të dhënë, konsiderohen si "plotësim apo qartësim i certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura në pajtim me nenet 65-71

të LPP-së". Rrjedhimisht, mungesa e tyre nuk paraqet bazë ligjore për refuzimin e tenderit".

Duhet cekur se Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin raportit të ekspertit lidhur me këtë pretendim ankimor pasi që eksperti shqyrtues në këtë rast nuk argumenton pse janë të qëndrueshme pretendimet e operatorit ekonomik ankues por vetëm i citon tri (3) dispozita juridike në fuqi duke mos dhënë asnjë shpjegim përse gjendja faktike përkatëse i referohet pikërisht këtyre dispozitave të cituara. Në rastin konkret eksperti i referohet nenit 59 dhe 72 të LPP lidhur me nenin 10 të UPP të cilat flasin për dokumente shitesë me qëllim të sqarimit të dokumenteve që një tenderues ka dorëzuar me rastin e ofertimit. Në anën tjetër dokumentet për të cilat bëhet fjalë (çertifikatat ISO) janë pjesë përbërëse e kërkesave të dosjes së tenderit. Pra nuk bëhet fjalë për dokumente shitesë që janë dorëzuar për të sqaruar një dokument me rastin e ofertimit. Mirëpo bëhet fjalë për dokumente që është dashur të dorëzohen me rastin e ofertimit mirëpo si të tilla janë dorëzuar pas datës së hapjes së ofertave. Përndryshe nuk është fare kontestuese as nga vet operatori ekonomik ankues që dokumentet në fjalë kanë qenë kërkesa të dosjes së tenderit dhe si të tilla janë dorëzuar pas datës së hapjes së ofertave. Në këtë kuptim Paneli Shqyrtues ka gjetur se ky konstatim i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë ankimor nuk është i plotë dhe nuk është i qëndrueshëm. Rrjedhimisht paneli shqyrtues nuk i ka falur besimin raportit të ekspertit për shqyrtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Në anën tjetër përgjigja e autoritetit kontraktues në raportin e ekspertit ka qenë mjaft i detajuar dhe i argumentuar. Ngjashëm edhe fjala përfundimtare e autoritetit kontraktues ka qenë e bazuar tërësisht në LPP dhe RRPP duke u mbështetur në faktet dhe dokumentet konkrete të aktivitetit të prokurimit. Në këto dy elaborime autoriteti kontraktues në mënyrë bindëse ka shpjeguar se në rastin konkret operatori ekonomik ankues ka dorëzuar dokumente që kanë qenë kërkesë e dosjes së tenderit pas datës së hapjes së ofertave. Një veprim i tillë është në kundërshtim të plotë me LPP pasi që dorëzimi i ofertave apo pjesëve të saj pas hapjes së ofertave nuk lejohet sipas nenit 58 dhe 72 të LPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë përgjigjes së AK ndaj raportit të ekspertit, fjalës përfundimtare si dhe vendimit të datës 26.04.2023 sipas të cilës është refuzuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik ankues. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë (I) dhe i dytë (II) të Operatorit Ekonomik Ankues janë pretendime të bazuara në tërësi.**

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor, eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës nuk ka trajtuar fare këtë pretendim. Me këtë rast paneli shqyrtues ka marrë parasysh edhe faktin se operatori ekonomik ankues ka njoftuar se pajtohet në tërësi me raportin e ekspertit shqyrtues. Në anën tjetër operatori ekonomik ankues as në ankesë por as në seancën e shqyrtimit dhe as në provat tjera të prezantuara nuk ka arritur të saktësoj se cilat pretendimet të kërkesës për rishqyrtim nuk janë shqyrtuar nga autoriteti kontraktues përmes vendimit të datës 26.04.2023. Duke marrë parasysh këtë gjendje faktike paneli shqyrtues. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i tretë (III) i Operatorit Ekonomik Ankues është pretendim i pabazuar në tërësi.**

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) ankimor, eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës nuk ka trajtuar fare këtë pretendim. Me këtë rast paneli shqyrtues ka marrë parasysh edhe faktin se operatori ekonomik ankues ka njoftuar se pajtohet në tërësi me raportin e ekspertit shqyrtues. Në

anën tjetër operatori ekonomik ankues as në ankesë por as në seancën e shqyrtimit dhe as në provat tjera të prezantuara nuk ka arritur as të saktësoj dhe as të provoj pretendimet e tij. Për më tepër ky pretendim i referohet dokumenteve ofertuese të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Përderisa nuk dëshmohet se operatori ekonomik ankues është tenderues i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me këtë pretendim ankimor dhe në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Duke marrë parasysh këtë gjendje faktike paneli shqyrtues. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i katërt (IV) i Operatorit Ekonomik Ankues është pretendim i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e pestë (V) ankimor, ekspertit shqyrtues përmes raportit të ekspertizës nuk ka trajtuar fare këtë pretendim. Me këtë rast paneli shqyrtues ka marrë parasysh edhe faktin se operatori ekonomik ankues ka njoftuar se pajtohet në tërësi me raportin e ekspertit shqyrtues. Në anën tjetër operatori ekonomik ankues as në ankesë por as në seancën e shqyrtimit dhe as në provat tjera të prezantuara nuk ka arritur as të saktësoj dhe as të provoj pretendimet e tij. Për më tepër ky pretendim i referohet dokumenteve ofertuese të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Përderisa nuk dëshmohet se operatori ekonomik ankues është tenderues i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me këtë pretendim ankimor dhe në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP ku përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Duke marrë parasysh këtë gjendje faktike paneli shqyrtues. **Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i pestë (V) i Operatorit Ekonomik Ankues është pretendim i pabazuar në tërësi.**

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Po ashtu duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 18.04.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë azbest” me numër të prokurimit 616-23-14667-2-1-1 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kimete GASHI
Kryetare e Panelit Shqyrtues

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës,

1x1 OE-ve ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.